



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Mbrojtja e bimëve

Programi: Mbrojtja e bimëve-Fitomedicinë

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Egzon Kabashi, me titull: “Ndikimi i plehut të krimbit të miellit dhe mulqërimit në paraqitjen e barojave dhe kultivimin e kamomilit”

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 01.05.2024 deri me datë 08.05.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Ass.dr. Muhmaet Zogaj, kryetar,
2. Prof. Dr. Arben Mehmeti, mentor - anëtar,
3. Prof. Asoc.dr. Fadil Musa, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof.dr. Arben Mehmeti, përmes e-mail adresës arben.mehmeti@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

ABSTRAKT

ABSTRAKTI

Barojat shkaktojnë dëme mjaft të mëdha gjatë kultivimit të kamomilit dhe mjaft vështirë është të kontrollohen. Përveç masave agroteknike plehërimi ka ndikim në paraqitjen e barojave në kamomil. Për këtë qëllim janë kryer hulumtimet gjatë vitit 2023 për ndikimin e plehrave (frass dhe plehra artificiale) dhe mulqërimit me byk në paraqitjen e barojave. Madhësia e rievimeve të kryera ka qenë $1 \times 1 = 1 \text{ m}^2$. Gjatë vegjetacionit janë kryer dy here rievimet gjatë muajit prill dhe maj. Në eksperiment gjithsej kanë qenë tetë tretmanë, tre me sasi të ndryshme të plehërimit me frass (pleh nga *Tenebrio molitor*-krimbi miellit), një me plehërim të kombinuar frass + NPK 15:15:15, një frass + NAG-27%, një me plehërim themelor NPK 15:15:15, tretmani me mulqërim (byk nga druri) dhe ngastra kontroll. Barojat e regjistruara në kamomil ju takojnë 11 familjeve, kurse llojet dominante ishin nga familja *Fabaceae*, *Plantaginaceae* dhe *Poaceae* me nga dy lloje, kurse familjet tjera janë përfaqësuar me nga një lloj. Llojet dominante të barojave në kamomil ishin: *Capsella bursa-pastoris* (shtrapëra), *Plantago lanceolata* (gjetthedelli heshtor), *Myosotis arvensis* (lulemiza e arave) dhe *Aphanes arvensis* (këmbëluani). Nga 14 lloje të barojave në kamomil, 85.7% janë gjethegjera dhe 14.3% gjethengushta, kurse sa i përket ciklit biologjik 64.3% janë njëvjeçare dhe 35.7% janë shumëvjeçare. Numri më i vogël barojave është regjistruar në ngastrat ku është përdorur frass në sasi prej 1.0 t/ha + NAG-27%-500 kg/ha, me 12.6 baroja/m². Në ngastrat ku është përdorur plehut artificial NPK 15:15:15-450 kg/ha, numri i barojave ishte më i lartë me 17.8 baroja/m², kurse në ngastrën kontroll janë regjistruar 14.3 baroja/m². Ndikimin më të lartë në biomasën e freskët të kamomili e ka pasur tretmani ku është kombinuar përdorimi i frass 1 t/ha dhe NPK 15:15:15-450 kg/ha (3.475 g/m²) dhe tretmani ku është përdorur frass në dozë prej 5 t/ha (2.700 g/m²). Bimët në tretmanin ku është përdorur kombinimi NPK 15:15:15 dhe frass 1 t/ha, kanë lartësinë më të madhe mesatarisht 89.3 cm, kurse bimët në tretmanin kontroll kanë lartësi më të vogël mesatarisht 52.5 cm. Sa i përket elementeve ushqyese në tokë ka dallime ndërmjet tretmanëve, por dallime signifikante ka pasur për N(%), P₂O₅, K₂O, Mn, dhe MO(%).

Fjalët kyçe: frass, plehërat artificiale, barojat, kamomili